**KËRKESË**
**Nr. 95, datë 12.1.2026**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rehabilitimi i shesheve dhe zonave kryesore në afërsi të pikave doganore shqiptare’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall” dhe “kullotë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Vlerësimi i pasurisë së llojit “ndërtesë social-ekonomike” llogaritur me preventiv punimesh sipas VKM-së nr. 138, datë 3.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 2,401,066.5 (dy milionë e katërqind e një mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë pesë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Autoritetin Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Ermal Shena**

# LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I SHESHEVE DHE ZONAVE KRYESORE NË AFËRSI TË PIKAVE DOGANORE SHQIPTARE"

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Të dhënat e pasurisë | | | | | | | Vlerësimet për shpronësim sipas llojit | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | Truall | | | Kullotë | | | Ndërtesë soc.-ekonomike | | | |
| | | | | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale $m^2$ | Truall | Kullotë | Ndërtesë | Sipërfaqja e shpronësuar $m^2$ | Çmimi | Vlera | Sipërfaqja e shpronësuar $m^2$ | Çmimi | Vlera | Sipërfaqja e shpronësuar $m^2$ | Vlera sipas preventivit | Vlera totale (lekë) | Shënime |
| 1 | Ernest | | Popaj | 1964 | 1040/3 | TRUALL | 133.7 | 133.7 | | 62.9 | 133.7 | 231.00 | 30,884.70 | | | - | 62.90 | 2,139,115.80 | 2,170,000.50 | |
| 2 | Kemal<br>Enver<br>Myfit | Elmaz<br>Elmaz<br>Elmaz | Libohova<br>Libohova<br>Libohova | 2030 | 260/3 | Kullotë | 230,134 | | | | | | | 493 | 198.00 | 97,614.00 | | | 97,614.00 | Indeksi i hartës K-34-5-(76-A), K-34-5-(60-C) ref. 058 pajisur me certifikatë pronësie datë 6.11.2008, certifikatën e parë humbur sipas deklaratës noteriale urdhër i regj. nr. 67, datë 6.11.2008, ref. 097. |
| 3 | Kemal<br>Enver<br>Myfit | Elmaz<br>Elmaz<br>Elmaz | Libohova<br>Libohova<br>Libohova | 2030 | 85/4 | Kullotë | 28,866 | | | | | | | 674 | 198.00 | 133,452.00 | | | 133,452.00 | Ref. 062, pajisur me certifikatë datë 8.6.2009 certifikata e parë humbur sipas deklaratës noteriale nr. 32828 rep. nr. 1807 kol., datë 31.10.2008, urdhër regjistruesi nr. 113, datë 8.6.2009 me sip. 28866 $m^2$ është përfshirë dhe sip. nën objekte e cila është fshirë me vendimin nr. 39, datë 2.6.2009, të kryeregjistruesit për pas, 85/19 V8F190, pas. 85/18 V8 F 175, pas. 85/19N12 V8 F 193. |
| | SHUMA PARAPRAKE | | | | | | | | | | | | | | | | | | 2,401,066.50 | |